

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Blerje materiale pastrimi”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**39831200-8, 39831210-1, 39224320-7, 39224000-8, 39224100-9, 39830000-9, 39831000-6, 39831250-3,  
39831300-9, 39831600-2, 39832000-3.**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**- Fondi total 16 644 498.21 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dyzetë e katër mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë pikë njëzet e një) lekë pa T.V.SH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurrohet.

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore për vitet financiare 2021, 2022 ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

\_\_\_\_\_ Adresa: Rruga “Barrikadave”, KodiPostar 1001, tel.:+355 42222991, ëeb: femijetetiranes.al, email:femijet@tirana.al\_\_\_\_\_

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

*(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).*

### **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

- 2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqese deshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.
- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasitë dhe llojin e mallrave të furnizuara.
  - Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasitë dhe llojin e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe **nenin 40, pika 4** (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 40 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenin 40 pika 4 e VKM nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 40 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon **1 (një) mjet transporti** me “masë maksimale te autorizuar” jo më pak se 3 ton për transportin e materialeve të pastrimit, ne pronësi ose ne perdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon **1 (një) mjet transportime** “masë maksimale te autorizuar” jo më pak se 3 ton, ne pronësi ose ne perdorim sipas kontrates noteriale, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie
- siguracion (TPL)
- çertifikatë e kontrollit teknik
  - Në rastin kur automjeti është me qera, të paraqesë kontratën noteriale përkatëse si dhe dokumentat e kërkuara të automjetit.

**Argumentim:** Kriteri që OE duhet të paraqesë vetdeklarimin ku të deklarojë se disponon 1 (një) mjet transporti me “masë maksimale te autorizuar” jo më pak se 3 ton për transportin e materialeve të pastrimit është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës për procedurën e lëvrimit të mallrave. Mallrat do të lëvrohen nga OE pas kërkesës së AK në magazinën e AK, në kohë të ndryshme dhe me sasi të përcaktuara që do të llogariten herëpashere sipas nevojave të çerdheve dhe kopshteve si dhe sipas mundësisë së magazinimit. Përcaktimi i kapacitetit të automjetit të kërkuar “jo më pak se 3 ton” është vendosur duke patur parasysh sasinë, peshën dhe volumin e madh të materialeve të pastrimit që duhen lëvruar.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet te disponoje çertifikatën ISO 9001:2015, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente dhe ISO 14001:2015 për sistemin e menaxhimit të mjedisit ose ekuivalente, të vlefshme, për prodhimin dhe/ose tregtimin e produkteve object prokurimi.

- **Argumentim:** Kriteri që OE ofertues duhet te paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente të saj, të vlefshme, per tregtimin e produkteve, konsiston në kërkesën që ai duhet të zotërojë “Sistemin i menaxhimit të cilësisë” së produkteve që ai tregëton, nisur dhe nga fakti që produktet e prokuruar do të përdoren në ambjentet e çerdheve dhe kopshteve të cilat janë ambjente rezident për fëmijë të grupmohës 6 muaj-6 vjeç.

- Kriteri që OE ofertues duhet te paraqesë Çertifikatën ISO 14001:2015 ose ekuivalente me të për sistemin e menaxhimit të mjedisit, konsiston në kërkesën që ai duhet të zotërojë “Sistemin i menaxhimit të mjedisit” për produktet që ai tregëton. Duke marrë në konsideratë natyrën e

produkteve që kërkohen (përbërësit kimik të tyre), natyrën e aktivitetit të operatorëve ekonomikë, si dhe lidhur ngushtë me kërkesat tona për cilësitë teknike të artikujve dhe ndikimin e tyre në mjedis, (kryesisht përsa i përket (detergjenteve të rrobave, solucioneve), është konsideruar e arsyeshme nga ana jonë kërkesa e këtij certifikimi.

#### 2.3.4 Vetëm për produktet:

| Nr | Emërtimi i produktit             |
|----|----------------------------------|
| 1  | Detergjent rrobash               |
| 2  | Solucion larës enësh.            |
| 3  | Solucion, zbardhues, dizifektues |
| 4  | Ilaç xhamash                     |
| 5  | Solucion pllakash                |
| 6  | Sapun rrobash                    |
| 7  | Sapun tualeti                    |
| 8  | Solucion për pastrimin e sobave  |
| 9  | Solucion parketi                 |

OE duhet të paraqesë:

a) **Raport Analizë** nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), ose laborator tjetër ekuivalent.

Raport Analiza duhet të përmbajë të gjithë treguesit dhe parametrat e kërkuar për secilin produkt në specifikimet teknike.

b) **Skedat Teknike dhe Skedat e Sigurisë të tyre.**

Në skedat teknike dhe skedat e sigurisë të produktit, duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave të kërkuara me produktet e ofruara.

*(Skedat teknike dhe skedat e sigurisë duhet të jenë në gjuhën shqipe, dhe nëse janë në gjuhë të huaja duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara)*

**Argumentim:** Kriteri që, për mostrat e tipit detergjentë, solucionet dhe sapunët, sipas listës së kërkuar, OE duhet të paraqesë Raport Analizë nga ISHTI (Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial) ose laborator tjetër ekuivalent është vendosur që OE të vërtetojë që mostra e paraqitur, është analizuar dhe se plotëson të gjitha parametrat dhe treguesit e përcaktuar në specifikimet teknike.

Kriteri që, për mostrat e tipit detergjentë, solucionet dhe sapunët, sipas listës së kërkuar, OE duhet të paraqesë skedën teknike dhe të sigurisë të produktit është vendosur si kërkesë e ligjit. Nr. 10216, datë 21.01.2010, “Për detergjentët” neni 9 pika 1, ku përcaktohet që: Fabrikuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar ose importuesi, që vendos në treg detergjentet ose substancat tensioaktive në detergjente, ka detyrimin të kalojë informacionin e përgjithshëm për produktin përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit.

\_\_\_\_\_ Adresa: Rruga “Barrikadave”, KodiPostar 1001, tel.:+355 42222991, ëeb: femijetetiranes.al, email:femijet@tirana.al\_\_\_\_\_

2.3.5 Ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Një mostër për secilin artikull të kërkuar, objekt i këtij prokurimi.
- Mostrat duhet të jene ne perputhje me te gjitha specifikimet teknike te kerkuara.
- Mostrat do të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë D. P. Ç. K - ve, Rruga e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tiranë.
- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë elementët: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

- **Argumentim:** Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 40, pika 6/a. Kriteri i vendosur për paraqitjen e mostrave është kërkuar për të vërtetuar lidhjen midis OE konkurrues në raport me mostrën e paraqitur ditën e hapjes së tenderit dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur në SPE (dëshmit e raport analizave), për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit. Gjithashtu për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimin e kontrates.

#### **Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:**

Për përgatitjen e specifikimeve teknike, komisioni i është referuar Ligjit nr. Nr. 10216, datë 21.01.2010 “Për detërgjentët”, VKM nr. Nr.669, datë 28.9.2011 “Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detërgjentët”.

Parametrat e përcaktuar në treguesit respektivë janë vendosur në raport me kërkesat e AK për sigurimin e artikujve cilësorë si në këndvështrimin fiziko-kimik por edhe në këndvështrimin sasior që ka të bëjë me volumin, peshën specifike apo përmasat e tyre.

Duke iu referuar nevojave specifike të çerdheve dhe Kopshteve në funksion të shërbimit të pastrimit cilësor, për të cilin shërbejnë këto materiale, nga gjithë shumëllojshmëria e artikuj vetë ngjashëm, të markava të ndryshme tregëtare, që gjenden në treg, janë përzgjedhur ata artikuj të cilët kanë karakteristika të njëjta edhe pse janë të markave tregëtare të ndryshme por që në raport me çmimin dhe specifikimet përkatëse për secalin prej tyre, plotësojnë më së miri si nga ana cilësore por edhe nga ana sasimore këtë shërbim, i cili merr një rëndësi të veçantë për derisa është në funksion të çerdheve dhe Kopshteve si qendra rezidenciale për fëmijë të grupmoshave nga 6 muaj deri në 6 vjeç.

Përsa i përket konfeksioneve të përcaktuara për secalin artikull, janë lënë hapësirat e nevojshme minimale dhe maksimale, referuar paketimeve që gjenden në treg, por duke patur gjithmonë parasysh që ato të jenë në funksion të realizimit sa më praktik dhe funksional të procesit të shpërndarjes së këtyre produkteve nëpër çerdhet dhe kopshtet e Tiranës, si dhe në funksion të procesit të magazinimit.

Përshkrimi i produkteve të kërkuara është bërë në mënyrë të detajuar duke përcaktuar në mënyrë të qartë produktin e kërkuar nga ana cilësore dhe sasimore, duke mos krijuar konfuzion mbi produktet e kërkuara.

*Në lidhje me treguesit e përcaktuar në specifikimet e kërkuar për secilin produkt, kryesisht ato solucione, është e nevojshme të sqarojme se:*

- *Matja e densitetit është një parametër i rëndësishëm i cilësisë për produktet e pa përpunuara dhe të përfunduara në forma të ngurta dhe të lëngëta dhe kryhet me teknika të ndryshme. Matja e dendësisë, e cila është veçanërisht e rëndësishme në përcaktimin e pastërtisë së materialeve para përpunimit, është e rëndësishme për të përcaktuar nëse një material i huaj është i përzier me lëndën e parë. Nga ana tjetër ky tregues është në funksion të përcaktimit homogjenitetit të produktit.*
- *Treguesi i Ph (përmbajtja e joneve  $H^+$ ) tek solucionet e lëngshme dhe sapunët është shumë e rëndësishme për të përcaktuar neutralitetin (as acid dhe as bazik), sepse në të dy rastet ndikon negativisht në shëndetin e fëmijëve. Ndërsa në rastin e detergjentit pluhur, dhe solucioneve për pastrimin e sobave, zbardhues dezinfektues rrobash, kërkohet me Ph më të lartë duke kaluar në bazë për arsye të ndikimit në emulsionet shkumuese.*
- *Tretshmëria e substancave në ujë është një nga kushtet kryesore që ndikon në formimin e përbërjes. Sa më e lartë të jetë tretshmëria, aq më të pastra janë produktet.*
- *Treguesi i lagështirës është shumë i rëndësishëm pasi lagështia ndikon negativisht në jetëgjatësinë e produktit (shpërbën substancat).*
- *Substancat teknsioaktive-substancat organike ose përzierjet që janë lëndë përbërese të detergjentëve, që veprojnë në sipërfaqe dhe përbëhen nga një ose më shumë grupe hidrofile dhe hidrofobe dhe që kanë aftësinë të zvogëlojnë tensionin sipërfaqësor të ujit dhe të formojnë shtresa shpërndarëse ose thithëse monomolekulare në sipërfaqen e kontaktit ujë-ajër duke formuar emulsion ose mikroemulsione ose micela që thithen në kontakt me ujin dhe sipërfaqet e ngurta.*
- *Referuar përcaktimeve si “me aromë të mirë, të lehtë” në disa produkte objekt prokurimi sqarojme se, duke qënë se këto produkte janë parashikuar të përdoren në ambjente rezidenciale të frekuentuara nga fëmijë të moshave 6 muaj – 6 vjeç (çerdhe dhe kopshte) këshillohet që aromat e tyre të jenë sa më të lehta dhe të këndshme me ndjeshmëri sa më të ulët në shqisën e të nuhaturit të fëmijëve. Gjithashtu sqarojmë se AK, në zbatim të parimeve të përcaktuara në LPP, me qëllim që mos të shammgë apo ngushtojë konkurrencën në këtë procedurë prokurimi, nuk ka përcaktuar aroma specifike (aroma konkrete si psh lulesh, frutash, bimësh etj), por ka konsideruar që përcaktimi “e mirë” dhe “e lehtë” është gjithpërfshirës.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*